



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 152-25
Tarix/Dt. 29.08.2025	



Referenca : 626/25/007/521

Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 61 paragrafi 61.1 pika(a) lidhur me paragrafin 63.1.1 pika (a) të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 26.08.2025 të paraqitur nga Operatori Ekonomik Bajram Ha. Gashi B.I. nga SUHAREKA, bie këtë:

V E N D I M

I

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik Bajram Ha. Gashi B.I. nga Suhareka, e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 26.08.2025 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-25-5557-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-25-007-5-2-1 me titull “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”.

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik Bajram Ha. Gashi B.I. nga Suhareka me datë 26.08.2025 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse”.

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me vëmendje të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve: 7,10, 11, 52, 56, 59, 61, 62, 69 dhe 108/A të LPP-s si dhe nenet 40, 41, dhe 97 të RREGULLORES NR. 002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe Rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

O.E. ankues në lidhje me qasjen në dokumentacionin e tenderit ka pretenduar që nuk i është dhënë qasja në tërësi gjë e cila nuk është kontestuese, pasi që sikur e kemi njoftuar me rastin e qasjes O.E. i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar aneksin nr. 3 të dosjes së tenderit në të cilën ka kërkuar që informatat për dokumentet e kërkuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP të

mbeten sekrete afariste si dhe ka dhënë arsyetimin dhe ka përcaktuar dokumentet të cilat duhet të trajtohen si të tilla. AK pasi ka bërë versionin e pastruar të dokumenteve të Grupit të O.E. të rekomanduar, me kërkesë të O.E. ankues i ka dhënë qasje në dokumentacionin e pastruar me ç'rast i ka prezantuar të gjitha këto dokumente si dhe sipas kërkesës së tyre, përmes diskut USB ia ka dhënë një kopje të dokumenteve të versionit të pastruar. Pra pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e tenderit të njëjtit iu është dhënë qasja dhe nuk ka pasur vërejtje lidhur me dokumentet e marra gjë e cila vërtetohet me procesverbalin e datës 22.08.2025 ora 10:21 min.

Ndërsa sa i përket pretendimit se nuk i është dhënë qasje në dokumentacionin –Gjendja ekonomike dhe financiare (pika 8.1&8.2 e DT-së –kapaciteti ekonomik dhe financiar për dëshmitë përkatëse konsiderojmë që ky pretendim është i pa bazuar pasi që i janë dhënë Deklaratat e ATK-s në të cilat vërtetohet që Grupi i O.E. të rekomanduar i ka plotësuar kërkesat e Gjendjes ekonomike dhe financiare. Pra këtë e ka konfirmuar në procesverbal vetë përfaqësuesi i O.E. me rastin e qasjes në dokumentacionin e tenderit.

Edhe pretendimi që AK nuk ka ofruar versionin e pastruar është i pa bazë pasi që ne para publikimit të B58 Njotimi mbi vendimin e AK-s kemi përgatitur versionin e pastruar me ç'rast O.E. ia kemi ofruar këtë dokumentacion me rastin qasjes në dokumentacion të tenderi por paraprakisht kemi përgatitur versionin e pastruar duke hequr nga dokumentacioni të gjitha dokumentet që nuk janë publike dhe të cilat përmbajnë informata të klasifikuara si sekret afarist. Ndërsa të gjitha dokumentet që janë publike ia kemi ofruar operatorit ekonomik ankues pa ndonjë vonesë apo hezitim dhe e kemi njoftuar përfaqësuesin e O.E. ankues se jemi duke ia dhënë versionin e pastruar sepse grupi i O.E. i rekomanduar ka dorëzuar aneksin 3 të dosjes së tenderit e që ka të bëjë me sekret afarist. Andaj ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. Të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente apo se kemi diskriminuar ndonjë O.E.

Në pretendimin e dytë ankimor O.E. ankues ka cekur që Grupi i O.E. i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm sepse nuk i përmbush kërkesat e DT lidhur me listën e kërkuar të pajisjeve, të specifikuara nga Aneksi 8 i DT me arsyetimin se Gr. i O.E. nuk plotëson kërkesën për kamion me korp me mekanizëm për bartje dhe ngritje të shportës dhe se pajisja e tyre nuk i plotëson të gjitha kërkesat e specifikuara nga DT. AK ka shqyrtuar dokumentacionin në lidhje me pajisjet teknike të ofruara nga Gr. i O.E. të rekomanduar dhe ka gjetur që ky pretendim është i pa bazuar pasi që Gr. i O.E. i rekomanduar me tenderin e tyre ka dorëzuar një marrëveshje për shfrytëzim të pajisjes në fjalë si dhe si dëshmi i ka bashkangjitur librezën e qarkullimit dhe DUD-in e pajisjes.

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.*
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për parane për Autoritetin Kontraktues.*
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.*
- d. Objektivet/Integritet/Singeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin komprometim të objektivitetit ose integritetit.*
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.*
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.*
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”*

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e Grupit të O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

O.E. Ankues ka cekur se AK ka bërë shkelje të nenit 52 të LPP-s, mirëpo ky nen ka të bëjë me njoftimin e kriterëve për dhënien e kontratës. Ky nen i përgjigjet fazës së njoftimit të kontratës dhe kriterëve që AK ka vendosur ti përdorë për dhënie të kontratë. AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë shumë qartë ka përcaktuar që kriteri për dhënie të kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit, ndërsa në fazën e tenderimit nuk kemi pranuar ndonjë ankesë apo kërkesë për rishqyrtim të këtyre kushteve. Rrjedhimisht të gjithë O.E. të interesuar janë pajtuar me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe janë pajtuar që të dorëzojnë tenderin në pajtim me kushtet e tenderit.

Gjithashtu O.E pretendon se nuk është zbatuar neni 56, kurse ne si AK kemi aplikuar në përpikëri nenin 56 prej fazës së përpilimit të DT, kemi aplikuar të gjitha rregullat e LPP-s, sipas RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe UDHËZUESIT Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK duke aplikuar nenin 51, 28 dhe 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-s.

Sa i përket pretendimit të O.E se AK ka bërë shkelje të LPP-s, konkretisht të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderit, konsiderojmë që është i pabazuar pasi që ne kemi aplikuar me përpikëri këtë nenin 59 të LPP-s gjatë vlerësimit si dhe kemi aplikuar me përpikëri edhe dispozitat e nenit 41 paragrafi 41.1, 41.2, 41.6 dhe 41.10 pika (a) të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, duke ju përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjithashtu O.E si pretendim tjetër ka paraqitur në kërkesë se kinse është shkelur neni 61 i LPP-s. Duhet sqaruar se: neni 61 i LPP-S KA TË BËJ ME TENDERIN JO-NORMALISHT Të ULËT, ku në nenin 61 pika 1 thotë: Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni. Në bazë të nenit 61 të LPP-s, neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik 002/2024 Ndryshim-Plotësimi i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, me datën 07.08.2025 përmes shkresës “B41 Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët” kemi kërkuar nga O.E. i rekomanduar që të na jep sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit duke kërkuar sqarim për disa pozicione të cilat komisioni vlerësues i ka konsideruar si jo normalisht të ulëta.

Pas marrjes së përgjigjes për sqarimin e kërkuar nga shkresa B41 komisioni vlerësues ka konstatuar se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të saj dhe ka trajtuar ofertën në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Nga kërkesa për sqarim është kërkuar nga Gr. i O.E. të rekomanduar që të na jep sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta dhe të paraqesë referenca në të cilat e ka bazuar çmimi me rastin e dorëzimit të ofertës dhe si dëshmi të na paraqet fatura ose kontrata të natyrës së njëjtë. Gr. i O.E. sikur e ka cekur edhe vetë O.E. ankues ka dorëzuar përgjigjen dhe i ka bashkangjitur si dëshmi faturat. Është në diskrecion të Autoritetit Kontraktues të vlerësoj përgjigjen e marrë nga ana e O.E. dhe nëse vlerëson që përgjigja është e mjaftueshme të trajtoj tenderin si të barabartë me tenderët tjerë e edhe të shpërblejë me kontratë nëse ka dorëzuar çmimin më të ulët në bazë të poentimit.

Ndërsa sa i përket pretendimit që dokumenti i përgjigjes nuk ka datë dhe nuk mund të verifikohet se a e ka kthyer përgjigjen O.E. në afatin e kërkuar prej 5 ditëve, konsiderojmë që një gjë e tillë është lehtësisht e verifikueshme pasi që përgjigja është dorëzuar tek AK përmes sistemit të prokurimit elektronik i cili regjistron datën dhe kohën e saktë të dorëzimit të dokumentit. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Kërkesa drejtuar Gr. të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratë për rritje të sigurisë së ekzekutimit nga 9,000.00 sa ka qenë i kërkuar në dosje të tenderit në 27.000.00 është e bazuar në nenin 29 paragrafi 29.4 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK andaj duke u bazuar në këtë dispozitë ne vetëm e kemi plotësuar një kërkesë ligjore dhe jo për ta konsideruar të vlefshme ofertën në bazë të rritjes së sigurimit të tenderit sikur ka pretenduar O.E. ankues pasi që AK së pari është bindur me përgjigjen e Grupit të O.E. të rekomanduar dhe pastaj ka bërë një kërkesë të tillë. Andaj edhe ky pretendim është i pa bazë.

Pastaj tjetër pretendim i O.E. ankues është se kemi shkelur nenin 62 të LPP-s. Sa i përket këtij neni duhet të sqarojmë që neni 62 ka të bëjë me përfundimin e aktivitetit të prokurimit. Në dispozitat e këtij neni është paraparë mundësia e anulimit të tenderit e që në rastin tonë nuk ka lidhje me veprimet e Autoritetit Kontraktues pasi që ne nuk e kemi anuluar këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket pretendimit të O.E. ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi që Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në përpikëri nenin 69 të LPP-s me ç'rast duke ju referuar nenit 69 të LPP-s ka përcaktuar kërkesat kualifikuese për pajisjet teknike të cilat duhet ti paraqet një O.E. për tu konsideruar i përgjegjshëm. Edhe për këtë pjesë nuk kemi pasur kurrfarë kërkesë për rishqyrtim të kushteve gjatë fazës së dorëzimit të tenderit dhe operatorët ekonomik pjesëmarrës ndër ta edhe O.E. ankues janë pajtuar që të dorëzojnë tenderin në përshatje me kushtet e kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Lidhur me pretendimet e paraqitura për pozicionet jo normalisht të ulëta Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarim për tender jo normalisht të ulët nga Gr. i O.E. të rekomanduar për shkak se i ka plotësuar kërkesat e parapara në nenin 61 të LPP-s për tu konsideruar si tender jo normalisht i ulët. Sqarimin e ka kërkuar më dt: 07.08.2025 nga Grupi i O.E të rekomanduar të cilët i janë përgjigjur kërkesës së AK-s më dt:11.08.2025 ora 17:43 min. Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të tenderit i ka klasifikuar artikujt të cilët janë cilësuar si jo normalisht të ulët në krahasim me çmimet e tregut dhe për këta artikuj ka kërkuar që të jepet sqarim se ku është referuar Gr. i O.E. të rekomanduar me rastin e vendosjes së çmimeve dhe si dëshmi ka kërkuar që të paraqet fatura apo kontrata të ngjashme në të cilën do të evidentohen artikujt e ngjashëm. Autoriteti Kontraktues përgjigjen e dhënë nga Grupi O.E të rekomanduar e ka vlerësuar si të mjaftueshme dhe e ka trajtuar këtë ofertë si të përgjegjshme në bazë të legjislacionit të prokurimit në fuqi, andaj oferta e tyre është konsideruar e përgjegjshme dhe është trajtuar njëjtë me ofertat tjera sikur është kërkuar në dispozitat ligjore për tenderët jo normalisht të ulët. Andaj konsiderojmë që edhe pretendimi për tenderin jo normalisht të ulët është i pa bazuar.

Pra sikur kemi dëshmuar më lartë që nga fillimi i procedurës Njoftimi për Kontratë e deri te B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit KK Mamushë ka aplikuar në përpikëri të gjitha dispozitat e procedurës së prokurimit dhe se shkeljet e pretenduara nga O.E ankues janë të pa baza.

Ne si autoritet kontraktues jemi te thirrur dhe kemi kompetenca qe ne rast te shpalljes, hapjes, vendimit për tender dhe gjatë gjithë procedurës tjetër, të veprojmë sipas legjislacionit në fuqi e cila rregullon fushën e Prokurimit, andaj edhe në këtë rast kemi ndjekur te gjitha hapat e kërkuara nga LPP-ja për procedurën në fjalë.

Ndërkaq sa i përket pretendimeve te parashtruara nga O.E ankues qe kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar ne përpikëri të gjithë procedurën, dhe konsiderojmë që pretendimet nuk janë të bazuara. Në analizimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të çështjeve te cilat O.E. ankues i ka theksuar në kërkesën për rishqyrtim, aspak nuk mendojmë që kemi bërë shkelje të legjislacionit të Prokurimit Publik.

Andaj

Me qenë se Operatori Ekonomik kërkesën për rishqyrtim e ka bërë duke mos pasur kurrfarë baze juridike në parashtrimin e kërkesës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me 29.08.2025

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimit
Komuna Mamushës

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.